



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURORE
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 17 Date 31/03/2016

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË DETAJURA PËR NDIHMË FINANCIARE PËR FAMILJET NË NEVOJË ME FONDET E BASHKISË URA VAJGURORE.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.03.2016 ,mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Ndihmës Ekonomike, pranë Bashkisë në mbeshtetje të ligjit me nr, 139/2015”Per Veteqeverisjen Vendore “,Ligji Nr 9355 datë 10.03.205”për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”i ndryshuar,VKM nr 787 datë 14.12.2005”për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”të ndryshuar,VKB nr 2 datë 0303.22016”për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Ura për vitin 2016”,shkresës së Prefektit të Qarkut Berat me nr 206/4 prot datë 15.02.2016,për konfirmimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak Ura Vajgurore të datës 02.02.2016 si dhe Urdhërit Nr 76 datë 18.03.2016 të Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore :

VENDOSI

Me 12 vota PRO nga 12 Këshilltarë prezentë:

Të miratojë kriteret e detajuara për të ndihmuar financiarisht familjet në nevojë me fondet e Bashkisë ,të cilët nuk përfitojnë nga Buxheti i Shtetit,të përcaktuara në Ligjin Nr 9355 datë 10.03.2005”Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”,i ndryshuar të cilët kanë gjëndjen civile në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore.

1.Përfitojnë ndihmë ekonomike individët apo familjet në risk dhe në nevojë të cilët nuk plotësojnë kriteret për të fërfitur nga skema e ndihmës ekonomik,e cila financohet nga buxheti i shtetit dhe që mund të jenë:

- Familje në varfëri ekstreme,me banesa të rrënuara që kanë të ardhura të pamjaftueshme për jetesën
Dokumentacioni :
 - 1.Kërkesë për ndihmë ekonomike
 - 2.Certifikatë familjare
 - 3.Proces –Verbalin nga grupi I verifikimit (shoqëruar me fotografi të banesës).
 - 4.Vërtetim për të ardhurat në familje.
 - 5.Masa e ndihmës ekonomike do të jetë në bazë të strukturës familjare dhe kriterëve.

- Kryefamiljare gra me fëmijë të mitur,që i kanë vdekur bashkëshortët.
Dokumentacioni:
 - 1.Kërkesa.
 - 2.Certifikata familjare.
 - 3.Deklaratë e cila vërteton që nuk përfitojnë ndihmë financiare nga shoqata të tjera.
 - 4.Masa e ndihmës ekonomike do të jetë në bazë të strukturës familjare dhe kritereve.

- Individë me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda me rrezik jete,fizike,sëmundje me origjinë tumorale,mendore,skizofreni,të cilat nuk përfitojnë pagesë nga PAK .
Dokumentacioni :
 - 1.Kërkesa.
 - 2.Certifikatë familjare.
 - 3.Epikrizë e diagnostikimit të sëmundjes.
 - 4.Faturën e shpenzimeve për mjekim

- Familje të cilat kanë dëmtime të rënda materiale,për shkaqe natyrore,nga zjarri,përmbytja etj.
Dokumentacioni :
 - 1.Kërkesa
 - 2.Proces Verbalin e konstatimit nga grupi i verifikimit i shoqëruar me fotografi,të pasqyruara dëmet e shkaktuara.

- Individë të cilët kanë bërë ndarje mbas 1 Korrikut 1993,që sot janë mbi 50 vjec.
Dokumentacioni :
 - 1.Kërkesa
 - 2.Certifikatë familjare e cikluar nga Gjendja Civile.
 - 3.Verifikimin nga Sektori i Ndhmës Ekonomike që nuk përfitojnë Ndhmë Financiare nga Institucionet Shtetërore të tjera.

2.Masa e Ndhmës Ekonomike do të jetë në bazë të strukturës familjare dhe kritereve.

3.Masa e Ndhmës Ekonomike mujore do të jetë në varësi të fondit të akorduar nga Bashkia Ura Vajguore.

4.Në dosjen e kryefamiljarit që do të trajtohet me ndihmë ekonomie,duhet të jetë i sistemuar i gjithë dokumnetacioni i mësipërm,sipas kategorive.

Për konfirmim në Prefekturë

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha

Elis Gjata



Adresa :Rruga " Dimal "

Telefon/fax 036122468

Lagjia " 18 Tetori " Ura Vajguore

e mail: bashkiauravajguore@ymail.com